

2. Mekanizmat e përfutimit të njërive

«...Kjo është një lojë që ata shpresojnë ta fitojnë e me të drejtë mund të thuhet se komikja nuk është kurrë e pafajshme...»

Groupe µ [1970]*

Shpesh është vënë në dukje se ligjërimi studentor, ashtu si të gjitha ligjërimet rinore, karakterizohet prej mungesës së origjinalitetit. E kjo është kuptuar në dy mënyra: a) në raport me varësinë e dukshme prej gjedheve të fjalëkrijimit që nden përpara këtij ligjërimi gjuha e folur e përbashkët dhe b) në raport me ngjashmëritë që shfaqin procedetë e ndjekura në ligjërimet të këtij lloji nëpër vende të ndryshme. Për sa i takon së parës, jam i mendimit që teksa gjykojmë kreativitetin e ligjërimin studentor duhet të mbajmë parasysh edhe cilësinë e produktit, e jo vetëm shtampën sipas së cilës është prodhuar ai; ndërsa lidhur me të dytën besoj që, më fort se një e metë, ajo është një vlerë, sepse dëshmon për karakterin universal të dukurisë.

Unë bëj fjalë për mekanizma të përfutimit të njërive dhe jo thjesht e vetëm për mënyra fjalëformimi, sepse ajo që ndodh në ligjërimin studentor e kapërcen fjalëformimin si proces; për këtë mjafton të kujtoj huazimet dhe prapashtesimin parazitare. Ndërsa, nga ana tjetër, ato që përfutohen nuk janë vetëm fjalë, por edhe shprehje. Prof. Qemal

* Cituar sipas Wolf-Dieter Stempel, *La rhétorique des jeunes*, në *La lingua dei giovani* (nën kujdesin e Edgar Radtke-s), Tübingen-Narr, 1993, f. 89.

Haxhihasani i përfshin të folmet *shoqnore* të nxënësve të Normales në grupin e atyre ‘varianteve’ «që kanë si bazë komunikimi gjuhën e përbashkët të shndrueme me mjete alternimi mekanik»¹, me të cilat ky studiues kupton «kombinimet e rrokjeve argotike, si p.sh. mbas rrokjeve që formohen me *-u-* shtohet rrokja *-furt*, mbas rrokjeve me *-y-*, *fyrt* [...]; kthimin e fjalëve mbrapsht (*imzilanoicanretni ra telorp* – internacionalizmi proletar), si dhe shformimet e fjalëve të gjuhës amtare me anë të metatezës e anagramës, p.sh. nxansit e ish-shkollës normale të Elbasanit në vitet 1930 – 1935 kanë pasë përdorë ma tepër zhvendosjen e rrokjeve, vendosjen e rrokjes së mbrapme para së parës vete/*te-ve*, shkolla/*lla-shko*; muri/*ri-mu*; profesori/*sori-profe* etj.»². Ndonëse nuk ngjan e njëkohshme me njësitë e tjera për të cilat bën fjalë ky autor, *imzilanoicanretni ra telorp*, me tingëllimin e saj si të një shprehjeje ruse, zbulon parapëlqimin e të rinjve për fjalë të huaja, ose së paku për fjalë që tingëllonin çuditshëm. Te mekanizmat e përfimit të njësive shfaqen qartë lidhjet që ekzistojnë mes këtij entiteti dhe gjuhës së zakonshme e, po ashtu, aty del në pah edhe karakteri ludik e kriptik i ligjërimit studentor, prandaj shqyrtimi i këtyre mekanizmave merr një rëndësi të veçantë.

Është e natyrshme që për të prodhuar njësitë e tyre bartësit e këtij ligjërimit t’i drejtohen edhe figurës. E këtë e gjejmë si *l’ornatus in verbis singulis* dhe si *l’ornatus in verbis coniunctis*³. Në grupin e parë të figurave mbi fjalë të veçanta bëjnë pjesë *cub*, *i fort(ë)*, *njesh*, *figur(ë)*, *firm(ë)*, *valut(ë)*, *pjeshke*, *gjeometër*, *urithat*, *gërmadhë* etj. Ndërsa *njesh yll thurje*, *e ka zënë qymyri*, *kafshoi llamarinën*, *firma troka*, *i vari kollaren*, *sa i lodhur je*, *ka shkarje ledhi* etj., klasifikohen në grupin e dytë që përfshin shprehjet e figurshme. Nga shembujt e

¹ Qemal Haxhihasani, art. i cit., f. 120.

² Po aty.

³ Shih Jörg Albrecht, art. i cit., f. 30.

mësipërm del se pjesa më e madhe e tyre ngrihet mbi bazën e metaforës. Por nëse te disa syresh, si për shembull *njësh yll thurje, gjeometër, sa i lodhur je* etj., metafora është ‘eufemistike’, te të tjerat *firma troka, kafshoi llamarinën, i vari kollaren, Juripalla, kopilat e Ajnshtajnit, Filoqyli, urithat, gërmadhë* etj., ajo është ‘joeufemistike’ ose ‘disfemistike’. Paçka se nuk dallohet me një vështrim të parë, e tillë është edhe metafora *Piramida*, me të cilën studentët ripagëzuan në fillim të viteve ’90 muzeun e Enver Hoxhës në Tiranë. Që prej asaj kohe godina e ka ndërruar disa herë emërtimin zyrtar, fillimisht në QNK (Qendra Ndërkombëtare e Kulturës) e tash së voni në Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Pjetër Arbërori”, por ajo vazhdon të quhet, e jo vetëm nga studentët, *Piramida*. Jo rastësisht tek e njëjta godinë sot gjejmë edhe një bar që quhet *Mumja*. Ky fakt më shpie tek ideja se ligjërimi studentor krijon të tjera realitete.

Dallimi mes metaforave eufemistike dhe disfemistike e ka burimin te ngjyrimet kuptimore të tropit. Afërmendsh që këto lloje metaforash nuk janë karakteristike vetëm për ligjërimin e studentëve, por i has edhe në gjuhën e folur të përbashkët e, po ashtu, i gjen edhe në entitetet simotra të gjuhëve të tjera⁴.

Për vetë natyrën e tij, ligjërimin studentor nuk mund t’i mungonte as hiperbola, të cilën e gjen në njësi të tilla si: *yll bote, pabuks, yll fare, më iku truri, ma hoqi petllën, i papam* etj. Tërheq vëmendjen kjo e fundit, sepse në ligjërimin studentor ka një kuptim krejt të kundërt me atë të gjuhës së zakonshme ku do të thotë ‘njeri i pagdhundur’. Studentët e kanë zhvendosur plotësisht në pozitivitet, ngaqë për ta kjo fjalë shënon ‘një njeri aq të zot, sa s’i ka zënë syri kujt’. Është e vërtetë që studentët më shumë sesa kuptimit i kushtojnë kujdes tingëllimit të fjalëve, i cili, nga ana tjetër, është njëri prej aleatëve të tyre në përcjel-

⁴ Shih Edgar Radtke, art. i cit., f. 6.

ljen e dozave të larta të emotivitetit. Për këtë shkak njësitë e ligjërimit të tyre janë të prirura të shndërrohen në klishe, madje për disa syresh do të ishte më e drejtë të thuhej se kanë lindur të tilla. Ky është rasti i njësisë *ma hoqi petllën*, ku përveç trajtave të bashkuara të përemrit vetor *mal/ta/ia*, nuk mund të ndryshojë asnjë element tjetër.

Krahasimet *është si shpirt*, *është si rrush* të cilat nga një pikëpamje tjetër fare mirë mund t'i klasifikosh te zbulimet⁵, për nga forma u binden që të dyja modeleve të shqipes bisedore. Ajo që e dallon ndërtimin e parë prej së zakonshmes ka të bëjë me kuptimin. Elementi *shpirt* është përdorur edhe më parë në shqipe për të karakterizuar njerëzit, por cilësitë e shënuara prej tij kanë qenë morale dhe jo fizike (le të sjellim ndër mend sintagmën *shpirt njeriu*). Edhe në formulën zbuluese *shpirti i mamit* elementi në fjalë nuk tregon ndonjë veti fizike. Aq më pak mund të pretendohet diçka e tillë në lidhje me ndërtimin rinor *bën si shpirt i keq*. Tek *është si shpirt* e ligjërimit studentor kemi një zhvendosje kuptimore prej së mirës tek e bukura, meqë bartësit e tij e përdorin zakonisht për një njeri të bukur.

Dëgjon nga sytë, ç'po na shohin veshët janë përftuar me anën e bashkimit të elementeve që nuk pajtohen me njëri-tjetrin nga ana kuptimore. Pikërisht te ky lloj absurdi që njihet si figura retorike me emrin oksimoron qëndron edhe forca e tyre sugjestionuese, për shkak të së cilës ato përdoren në ligjërimin studentor.

Prej atij që mund të quhej 'zhargoni i kazermës' në ligjërimin e sotëm studentor hasim pak njësi, *rrul*, *daut* e *dajë*. Në krye të herës ato shënonin gjegjësisht ushtarët e vitit të parë dhe ushtarët e vjetër në prag të liritimit. Herë-herë *rrul* në ligjërimin studentor e has edhe për 'studentët e vitit të parë'. Shkurtaj njëren prej tyre, *daut*, e motivon me dorë-

⁵ Shih Gjovalin Shkurtaj, *Etnografi e të folurit të shqipes*, SHBLU, Tiranë, 2004, f. 159-164.

zoja *armën ushtarit të ri*⁶. Shpjegimi ngjan mbushamendës, edhe pse për t'iu bindur krejtësisht kësaj logjike tingulli fundor duhet të ishte *r* e jo *t*. Ndoshta këtu ka ndikuar edhe ngjashmëria e fjalës së përftuar me emrin e përveçëm *Daut*, çka, nga ana tjetër, zbulon edhe një karakteristike të ligjërimeve rinore të shqipes, e në mënyrë të veçantë të atij studentor, prirjen për të përdorur për efekte komike emra njerëzish, mysli-manë a të krishterë qofshin, me kusht që bartësve të tyre t'u tingëllojnë si të vjetër. I tillë është, fjala *vjen*, rasti i njësisë *okej Xhevrije* (në rregull, dakord), *në kohën e Dullës* (në kohën e Enver Hoxhës), ku emri i personazhit nuk është gjë tjetër veçse një shkurtim i emrit *Abdullah*, jo fort i rrallë në shqipe.

E lidhur në njëfarë mënyre me jetën ushtarake është edhe njësisia *i bën zbor*. Shumë prej bartësve të ligjërimit të sotëm studentor ka të ngjarë të mos e dinë fare se ç'ishte zbori, por kjo nuk i pengon ta përdorin, ngaqë ata, sidoqoftë, e perceptojnë si diçka të pakëndshme a të lodhshme. Një gjë e tillë kuptohet edhe prej konteksteve në të cilat e has ndërtimin në fjalë, që ruan megjithatë një ngjyresë përkeqësuese. Por tek *i bën zbor kompjuterit* me kuptimin 'e përdor shumë mirë' dhe *i bën zbor plazhit* me kuptimin 'vete shumë shpesh në plazh' shprehja metaforike e humbet thuajse krejt pejorativitetin për t'u kthyer në një klishe që vetëm një lidhje e largët idesh me bindjen për rastin e parë dhe me teprinë në të dytin mund ta bashkojë me njësinë-djep.

I ka dalë emri për ushtar me kuptimin 'kërkohet për ndonjë punë', është një njësi e hershme e ligjërimeve rinore të shqipes që ka kaluar edhe në gjuhën e folur të përbashkët, natyrisht jo me të njëjtën denduri përdorimi e, ndoshta, kjo e ka ndihmuar për të mbetur ende në ligjërimin studentor.

⁶ Shih Gjovalin Shkurtaç, *Etnografi e të folurit të shqipes*, SHBLU, Tiranë, 2004, f. 219.

Shoku që, me sa duket, është shndërruar në një *lemë flamur* vitet e fundit, e zhveshur krejt prej ‘ngarkesës ideologjike’, po përdoret me vlerën e një apelativi për t’iu drejtuar cilitdo njeriu të seksit mashkull jo të shtyrë në moshë në situata joformale komunikimi. Nga ana tjetër, ajo me këtë status i ka mënjanuar thuajse krejt nga ligjërimi studentor njësitë *mjeshtër* e *usta*, të cilat deri para pak kohësh të rinjtë i shtinin në punë për t’iu drejtuar edhe njerëzve që u shërbejnë⁷. Në këtë rastin e fundit unë shoh një përpjekje për ta zvogëluar distancën mes atij që flet dhe atij që duhet të bindet. Po ashtu, aty mund të shquash edhe gjurmë të asaj strategjie komunikative dybinarëshe që Erving Gofman e quan *shkëmbimi mbrojtës*⁸, e pikërisht të fazës së tij të parë, ‘*mbrojtjes*’, e cila për mendësinë e shqipfolësit do të tingëllonte më fort si ‘një marrje me të mirë’ e ndjekur nga kërkesa. Tri fazat e tjera, ‘*ngushëllimi*’ ose ‘përmbushja e kërkesës’, ‘*miradija*’ ose ‘falënderimi’ dhe ‘*minimizimi*’ nuk mungojnë në situata formale e gjysmëformale komunikimi edhe mes të rinjve, por në komunikimin joformal hasen rrallë. Për më tepër, ndodh që dy fazat e fundit të realizohen me anën e fjalëve dhe shprehjeve të huaja, si për shembull *grazie – non c’è di che*.

Te *pabuks* e *paleks* nuk është e vështirë të shquash përngjitjen e *pa* + emër në kallëzore + prapashtesën fjalëformuese *s*. Kjo e fundit nuk duhet ngatërruar me *s*-në përmes së cilës shqipja ka formuar emra vepruesi nga tema prodhuese foljore (pjesoret *gege* ose *jo*) të tipit *mësues*, *shërbyes*, *nxënës*, ngaqë *pabuks* e *paleks*, për sa i takon prapashtesës, sipas meje, janë formuar për analogji me *begs*, *polikums* e *filoqyls*. Kështu që *s*-ja për të cilën po flas përfaqëson në vetvete një zhvillim të brendshëm të ligjërimit studentor. Ajo e ka origjinën te shkurtimi i fjalëve të tilla, si *skënder/beg/as* në *begs*, ku pas reduktimit të *as*

⁷ Shih edhe Ilda Strori, punim diplome i cituar.

⁸ Cituar sipas Gaetano Berruto e Monica Berreta, *Lezioni di sociolinguistica e di linguistica applicata*, Liguori Editore, Napoli, 1977, f. 117.

është ndier si prapashtesë fjalëformuese dhe prandaj është përdorur si e tillë. Këtij përfundimi i vjen në ndihmë edhe fakti se ajo në ligjërimin studentor bashkohet kryesisht me tema prodhuese emërore. Edhe kësaj dukurie i ka paraprirë shqipja dialektore, në të cilën prapashtesa *as*, ‘e specializuar’ për formimin e emrave nga tema prodhuese emërore, sipas prejardhjes gjeografike ose përkatësisë në një grup, është reduktuar në *s*, për shembull *kavajs*, *tirons* etj. Kështu që në thelb *s*-ja e ligjërimin studentor përfaqëson një zgjerim semantik të prapashtesës fjalëformuese *as*, ose, për të qenë më i saktë, të njërit prej varianteve të saj. Me anën e kësaj prapashtese “të re” janë krijuar edhe njësi të tjera, për shembull *zhuls*, *friks* e *sigurims*, fjalë që shqipja bisedore, meqë pajtoheshin me gjedhet e saj, i ka pranuar me kohë.

Te njësitë *dita* e *Shën Leksit*, me kuptimin ‘dita e ndarjes së bursave’, ose *po vete të nxjerr Leksin nga burgu*, me kuptimin ‘po vete të tërheq paratë e bursës’⁹ kemi një lojë fjalësh që mbështetet te shoqërimi i ideve mes *lek* ‘para’ e *Leks*, shkurtimi i emrit të krishterë *Aleks*, çka e mundëson edhe përdorimin e fjalëzës *shën*.

Përngjitje e prapashtesim kemi edhe te njësia *vitparist* ‘student i vitit të parë’. Këtu elementet e përngjitura janë një emër e një mbiemër, ndërsa prapashtesa është ajo me prejardhje të huaj, *ist*. Përveç atyre që kam përmendur më lart me të njëjtën prapashtesë janë formuar edhe njësitë *repist*, *lekist*, *llapist* e *mallist*. Prapashtesën *ar* e gjejmë te *metalar*.

Interesante është në ligjërimin studentor edhe dukuria e ndajfoljezimit të pjesëve të tjera të ligjëratës. I tillë është, fjala vjen, rasti i njësisë *normal* (në origjinë mbiemër) që në këtë entitet përdoret shpesh me vlerë ndajfoljore. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me gjojaparashtesën *ultra*, me të cilën shqipja ka gatuar fjalë, si *ultratinguj*, *ultrareaksionar*,

⁹ Shih Gjovalin Shkurtaç, *Etnografi e të folurit të shqipes*, SHBLU, Tiranë, 2004, f. 215.

ultravjollcë, ndërsa të rinjtë e përdorin në sintagma të tipit *i rri ultra*¹⁰. Njësinë *ultrasit*, me kuptimin ‘grupi më i rrëmujshtëm i tifozëve’, ligjërimi i sotëm studentor e ka huazuar prej italishtes. Nën ndikimin e ligjërimeve rinore të Kosovës me të njëjtin funksion vitet e fundit po shtihet në punë edhe *super*. Ndajfoljezimit i janë nënshtruar, sipas meje, edhe emrat *gjemb* e *grenx* në përdorimet *i rri gjemb*, *i rri grenx*. Në të vërtetë, dukuria në fjalë nuk i takon vetëm ligjërimin studentor, shqipja bisedore na jep një model shumë më të hershëm me *u rregullua pikë*. Te *rob hallall* dhe *rob koti* kemi mbiemërzimin e një emri (*hallall*) e të një ndajfoljeje (*kot*).

Shkurtimet janë një tjetër mekanizëm mjaft prodhimtar i ligjërimin studentor dhe kjo është e kuptueshme, përderisa bartësit e tij janë të interesuar për një komunikim ‘të përshpejtuar’. Por shkurtimi si procede e ndihmon ligjërimin studentor edhe për të përmbushur *funksionin zhvlerësues*, sepse ndikon jo pak në përfitim e efekteve komike, ndërsa, nga ana tjetër, ai ndihmon edhe në fshehjen e kuptimit. Në ligjërimin e sotëm studentor mund të gjesh shkurtimin në trup të fjalës, ose sinkopën, te njësitë *presor*, *zysh(ë)*, *Polikumi*, ashtu siç gjen edhe shkurtimin në fund të saj, ose apokopën *tung*, *pede*, *debi*, *gabi*, *psiko*, *homo*, *porno*, *prosti*, *disko* etj. Pesë shembujt e fundit në të vërtetë janë huazime, por më ngjan se kam të drejtë t’i klasifikoj këtu, ngaqë ato janë shkurtuar brenda ligjërimin tonë studentor. Edhe pse ndonjë syresh, si fjala vjen *disko*, e hasim në ligjërime studentore të gjuhëve të tjera¹¹, unë jam i mendimit se bëhet fjalë për zhvillime paralele. Në ligjërimin e sotëm studentor nuk mungojnë as shkurtimet e përziera; një të tillë e gjen te fjala përshëndetëse *paçim* dhe te *begsat*. Kohët e fundit ka nisur të përdoret edhe një tjetër, *tëtëtë*, me kuptimin ‘etj., etj.,

¹⁰ Shih edhe Ilda Strori, punim diplome i cituar.

¹¹ Shih Marta Maddalon e Fabio Bianco, art. i cit.

etj.’, i cili më duket mjaft interesant, sepse në thelb përfaqëson një shkurtim të shkurtimit. Një kategori më vete përbëjnë shkurtimet e formuara me tingujt nistorë të fjalëve në emërtimet e përbëra, për shembull *UT-ja*, *QS-ja*, *QSUT-ja* etj.

Huazimet përbëjnë një nga mekanizmat më të rëndësishëm në përfitim e njësive të ligjërimit të sotëm studentor. Elementet e huazuara janë fjalë, terma që shpesh vijnë të shoqëruar me konceptet, shprehje dhe kalke. Falë frekuencës së madhe të përdorimit që kanë disa prej tyre si *lema flamur* mund të krijohet përshtypja se studentët janë “huazuesit e mëdhenj”. Por kjo ka të ngjarë të mos i përgjigjet së vërtetës¹². Pjesa më e madhe e *huazimeve të mirëfillta* (se ç’kuptoj me to do ta sqaroj më poshtë) vjen prej anglishtes e italishtes, por nuk mungojnë as huazimet nga spanjishtja; ndër to spikasin fjalë si *okay*, *hi*, *bye*, *ciao*, *hola*, *no problem*, *no coment*, *pub*, *non stop*, *let’s go*, *let it be*, *be happy*, disa prej të cilave me kohë janë kthyer në ‘ndërkombëtarizma’ e që nga ana tjetër mund t’i hasësh rëndom edhe në gjuhën e folur të përbashkët, siç është rasti i *okay* ose i *ciao*. Po këtu duhet të përfshihen edhe shkurtesat e huazuara nga gjuhë të tjera, si fjala vjen *VIP*, *SMS*, *ok*, *dixhej*, *pc* etj.

Një pjesë e *huazimeve të mirëfillta*, ndonëse të reja, janë aklimatizuar mirë në shqipe, duke iu nënshtruar edhe normës morfologjike në gjuhën tonë. Kjo ka ngjarë me *misi/miset* (por jo me *mister*, ndoshta për shkak të shoqërimit të pakëndshëm të ideve me *misrat*, që në gjuhën e folur nga të miturit mund ta dëgjosh edhe si *mistrat*, ose me format gramatikore të fjalës *mister* ‘e fshehtë’); me *eskortë/eskorta* (nga italishtja *scorta?*); nëse është vërtet kështu, atëherë kemi të bëjmë ose me atë që prof. Shkurtaç e quan *identifikimi shpërdorues*, ose me një lloj proteze

¹² Shih tabelën përmbljedhëse të rezultateteve lidhur me pyetëtorin në paragrafin e tretë të pjesës së dytë.

që lehtëson shqiptimin. I njëjti proces aklimatizimi ka ndodhur edhe me *butik/butikë* (nga frëngjishtja *boutique*); me *bosi/bosat*; me *kompjuteri/kompjuterat* e cila, me gjithë disa luhatje të formave të shumësit (si fjalë e huaj që del më *-er*, lipsej ta bënte shumësin me *ë*), që nga ana e tyre lidhen edhe me praninë e *ë-së* dy rrokje larg theksit, e ka zgjeruar mjaft çerdhen e saj të fjalëve, duke dëshmuar se është përshtatur mirë në gjuhën tonë.

Por nuk duket se kanë pasur të njëjtin fat disa njësi të tjera, si fjala vjen *navigoj në internet* e cila për ca kohë u ndesh me kalkun *lundroj në internet*, e që tani duket se ia ka lënë vendin një tjetër kalku *futem në internet*. Një hap drejt aklimatizimit ka hedhur edhe njësisia *çat/çati* nga anglishtja *chat*, me krijimin e foljes *çatoj* ‘futem në çat’, megjithatë më duket se ka pak të ngjarë që ajo ta zgjerojë çerdhen e fjalëve. Në një letërporosi që u drejtohej studentëve kam lexuar: *Ndalohet çati*. E pra hartuesi i letërporosisë, mbase edhe nën trysninë e modelit *Ndalohet duhani*, nuk kishte guxuar të shkruante *çatimi* e kjo, sipas meje, përbën një sinjal domethënës. Në ligjërimet rinore të italishtes foljen *chattare* e gjen me kuptimin ‘fjalosem në rrjet’¹³.

Disa prej huazimeve si *kolgate*, *palmolive*, *lines* paraqesin një tjetër veçori: janë fjalë të italishtes (ku tingëllojnë pak a shumë *kolgeit*, *palmëlaiv*, *lains*), prandaj është e qartë se bëjnë pjesë te huazimet grafike. Nuk jam dakord me ndonjë studiues që njësitë në fjalë i mban si të ardhura prej italishtes (edhe atje janë huazime grafike), me arsyetimin se shqipfolësit i paskan dëgjuar së pari ato nga goja e spikerëve italianë¹⁴. Edhe pse kjo mund të jetë e vërtetë, për shkak të audiencës së lartë që kishte radioja dhe televizioni italian në Shqipëri edhe para viteve ’90, shqipfolësit vazhduan ta quanin pastën e tyre të dhëm-

¹³ Shih Gaetano Berruto, *Prima lezione di sociolinguistica*, Editori Laterza, Roma-Bari, 2004, f. 115.

¹⁴ Shih Kristina Jorgaqi, *Leksione xhepi për gjuhën*, Dituria, Tiranë, 2000, f. 25.

bëve *kolinoz* dhe jo *kolgate*. Kjo, sipas meje, do të thotë se këto fjalë janë huazuar në të vërtetë bashkë me produktin që emërtojnë. Nga ana tjetër, ka pak të ngjarë që shqipfolësit t'i kenë ruajtur në kujtesë këto fjalë si huazime virtuale për t'i përdorur tamam në çastin kur në tregun e tyre u shfaqën së pari prodhimet në fjalë, d.m.th. pas viteve '90.

Një rast disi të ndryshëm përbën njësia *fans*, e ardhur, me sa duket, nëpërmjet italishtes si huazim grafik. Në favor të ndërmjetësim-it flet fakti që edhe në shqip ajo ka vetëm një kuptim si në italisht, domethënë 'admirues i flaktë', kurse në anglisht ka edhe kuptimin 'fanatik'. Kështu që ligjërimin të sotëm studentor nuk i mungojnë as të ashtuquajturat *huazime të tërthorta*. Formën e shumësit të kësaj fjale *fans*, të cilën e ruan në shkrim edhe italishtja, të rinjtë shqiptarë e përdorin për njëjësin; ndërsa për shumësin ata shtien në punë prapashtesën e shqipes *a*. Prandaj kemi *një fans/ca fansa*, për analogji me *një begs/ca begsa*, *një polikums/ca polikumsa* etj.

Pjesa më e madhe e huazimeve grafike në shqipe, e pra edhe në ligjërimin studentor, e ka burimin te anglishtja¹⁵, si një gjuhë ku fjalët ndryshe shkruhen dhe ndryshe lexohen. Por, për hir të së vërtetës, duhet thënë se në ligjërimin studentor ato janë më të pakta se në gjuhën e zakonshme dhe kjo është e kuptueshme. Megjithatë, atyre që shqyrtova më lart mund t'u shtohen *Pall Mall*, *Rothmans*, *LM* (marka cigaresh), *Dov* (nga *Dove*, një markë çokollatash), që të gjitha të ardhura nga gjuha e zakonshme, me të cilën bartësit e ligjërimin studentor bëjnë në këtë rast një lloj kompromisi. Afërmendsh që ata nuk mund të lëshojnë pe kur vjen puna te "emblemata" e tyre dhe këtu vjen në vështirim njësia *pab*, fjalë e huazuar nga anglishtja (shkruhet *pub*), e cila ka hyrë në shqipe përmes ligjërimin studentor në këta 5 – 6 vjetët e fundit. Këtë fjalë, së paku në fillim, të moshuarit e shqiptonin *pub*, si një huazim

¹⁵ Po aty.

grafik, ndërsa tani, nën tryshinë e ligjërit studentor të gjithë e kanë ndrequr në *pab*. Më duket me vend të theksoj se bartësit e ligjërit të sotëm studentor shfaqin një ndjeshmëri shumë më të madhe se pararendësit e tyre ndaj drejtshqiptimit të fjalës së huaj. E kjo, sipas meje, më fort se me një njohje më të mirë të gjuhëve nga huazohet (çka nuk vihet në dyshim), ka të bëjë me prirjen për t'i përdorur trajtat korrekte të fjalëve të huaja si një armë që tregon epërsinë e tyre ndaj të tjerëve.

Me anën e *identifikimit shpërdorues* që ka shpënë në njëfjalësimin e dy elementeve të apokopuara, në ligjërimet rinore të shqipes së viteve '80 u përfutua një njësi e cila mbijetoi deri pas '90-ës e që sot mund ta dëgjosh shumë rrallë. Nuk e kam fjalën për ndonjë "çudi", por për një njësi mjaft të njohur ndër të rinjtë e atyre viteve, për *iparenë*. Sot ia ka zënë vendin *hit parejd* (nga anglishtja *hit parade*), fundja aty e ka burimin, por ne "të paditurit" e kishim ripagëzuar kësisoj emisionin muzikor që transmetonte çdo të diel në orën 12.45 Radio Uno. Ky shembull flet qartë edhe për *funksionin vetëkorrigjues* të ligjërit studentor.

Interes të veçantë paraqesin disa njësi, fjalë a shprehje qofshin, të cilat tingëllojnë si të huaja, por, në të vërtetë, nuk janë të tilla. Në themel të tyre qëndron përngjashmimi tingullor me të huajën, i cili rëndom arrihet përmes prapashtesave anglicizuese, por shi për këtë arsye parazitare në raport me shqipen, të tipit *-ejshën*, përzierjes së kodeve dhe lojës së fjalëve. Për shembull: *urrejshën* (nga *urrej* + *ejshën*) me kuptimin 'i urryer', *propozejshën* (nga *propozoj* + *ejshën*) me kuptimin 'propozim', *diskutejshën* (nga *diskutoj* + *ejshën*) me kuptimin 'diskutim'¹⁶. Te *nuk diskoringet*, me kuptimin 'nuk diskutohet', kemi diçka të

¹⁶ Shih edhe Gjovalin Shkurtaç, *Etnografi e të folurit të shqipes*, SHBLU, Tiranë, 2004, f. 217.

ngjashme, që përftohet përmes njëfjalësimit të dy elementeve *disco* e *ring*, për shkak të jehonës që pati aty nga mesi i viteve '80 një emision i RAI-t, i cili titullohej "Disco Ring". Shkurtaj bën fjalë edhe për një tjetër njësi, *varius* (me sa duket nga *varja* + *us*), në të cilën ai shquan një prapashtesë latine¹⁷.

Të ngjashme me këto që përmenda janë edhe njësitë *bllokmen* (nga *bllok* + *men*) me kuptimin 'njeri i nomenklaturës së lartë në shtetin komunist' (anëtarët e Byrosë Politike bashkë me familjet e tyre banonin në një lagje të veçantë të Tiranës që njihet me emrin *Blloku*); *drogmen* (nga *drogë* + *men*) me kuptimin 'njeri që merr ose që shpërndan drogë'.

Te *kambist* 'ai që këmben valutë', e përftuar, sipas meje, nga italishtja *cambiare* + prapashtesën e huaj *ist*, me të cilën shqipja e nën shembullin e saj edhe ligjërimi studentor ka formuar disa emra vepruesi, si fjala vjen *xhepist*, hasim bashkimin e dy elementeve të huaja, por kjo nuk e bën këtë fjalë një huazim, pasi procesi ka ndodhur brenda ligjërimit tonë studentor.

Në italisht nuk e gjen fjalën *cambista*; me një kuptim të përafërt në këtë gjuhë përdoret sintagma *cambia monete*. Dukuria nuk është as e re dhe as vetëm e ligjërimit tonë studentor. Në ligjërimet rinore të italishtes është vërejtur më se një herë prania e njësive të tilla. Tipik është rasti i *cucador*, 'një që i ecën me vajzat', e cila nuk ekziston në spanjisht, pavarësisht se tingëllon si një lloj hispanizmi, e që është formuar prej foljes *cuccare* 'shtie në dorë' (në krye të herës njësi e zhargonit të paninarëve e tashmë pjesë e italishtes bisedore) dhe prapashtesës parazitare hispanizuese *dor*¹⁸.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Njoftimin e parë lidhur me këtë njësi ma ka dhënë prof. Vito Matranga i Universitetit të Palermos, të cilin e falënderoj përzemërsisht. Më vonë e kam hasur edhe në literaturë; shih Gaetano Berruto, *Prima lezione di sociolinguistica*, Editori Laterza, Roma-Bari, 2004, f. 113.

Në këtë lagje njësisë që njihen si *gjojahuazime*¹⁹, për t'i dalluar nga *të mirëfilltat* (me të cilat kuptoj jo vetëm huazimet që mbushin zbrazëti leksikore, por të gjitha fjalët e huaja), bëjnë pjesë edhe *la vita e koklavita*, një përzierje e italishtes me shqipen që do të thotë 'jeta është e koklavitur, e ngatërruar'; *zhytem e z'dal mo*, e cila, e shqiptuar shpejt, të jep përshtypjen e ndonjë shprehjeje frënge që nis me *je t'aime*, në të vërtetë është shumë më banale, sepse fjalë për fjalë do të thotë 'zhytem e s'dal më'²⁰; disa pseudoturqizma, si *sehirdynja* për 'televizor', *kallkandollap* për 'frigorifer', *gjurulldibodrum* për 'diskotekë', *bulldumkazan* për 'lavatriçe, makinë larëse'²¹, *yxhym millet lesh e li* për 'proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni', të cilat ligjërimi i sotëm studentor i ka trashëguar prej ligjërimeve të mëparshme rinore.

Në disa nga shembujt e fundit bashkohen qëllimisht dy fjalë me prejardhje turke, të cilat kanë hyrë me kohë në shqipe, ndërsa te *bulldumkazan* dhe *yxhym millet lesh e li* nuk është e vështirë të shquash fjalën onomatopeike *bulldum* dhe lokucionin me vlerë ndajfoljore *lesh e li* të shqipes.

Njësia *tung* e cila, për mendimin tim, përfaqëson në thelb një *huazim të brendshëm*, meqë pas gjasash ka ardhur prej ligjërimeve rinore të Prishtinës²², i qaset këtij grupi, për shkak se njëri prej motiveve që ndikuan në rigjallërimin e saj (dhe këtu pajtohem me Ilda Strorin) ka qenë ngjashmëria që shfaq ajo me disa fjalë të gjermanishtes. Por nuk duhet harruar as motivi tjetër, shkurtësia. Kjo e fundit, sipas meje, i ka ndihmuar edhe disa fjalë të tjera si *çau* (italisht *ciao*), *baj* (anglisht *bye*) të ngjiten në kuotat e *lemave flamur*. E jo vetëm kaq, ato

¹⁹ Shih edhe Ilda Strori, punim diplome i cituar.

²⁰ Shih Gjovalin Shkurtaj, *Etnografi e të folurit të shqipes*, SHBLU, Tiranë, 2004, f. 217.

²¹ Po aty, f. 218.

²² Shih Ilda Strori, punim diplome i cituar.

sot, për të njëjtën arsye, i përdorin thujtë të gjithë. Prandaj te *tung* kemi një gjojuazim të fshehtë.

Guarda linea e italishtes, me anën e *identifikimit shpërdorues*, që në këtë rast i afrohet më fort *lectio facilior*-it, u shndërrua në ligjërimet rinore të shqipes së viteve '80 në *gardalina* me kuptimin 'vijërojtësi', 'arbitri anësor në një ndeshje futbolli' që e ka edhe në gjuhën dhënëse. Ky shembull dëshmon prirjen e kundërt, atë të përafrimit të fjalës së huaj me fjalën shqipe.

Nga kalket tërheqin vëmendjen *më bëj një zile* (prej italishtes *fammi uno squillo*); *do të dëgjohemi* (nga italishtja *ci sentiamo*), e cila ka nisur të përdoret edhe me vlerën e një përsëritjeje, duke rivalizuar me formulën e shqipes bisedore *do të shihemi*; *del me x*-in që po e zhvendos për ditë e më shumë në negativitet *shkon me x*-in; *është i bërë* me kuptimin 'ka marrë drogë', sipas meje nga italishtja *è fatto*; *bar* me kuptimin 'marijuanë' (nga italishtja *erba*), kur shqipja të njëjtën fjalë e ka edhe me kuptimin 'ilaç'; *bën sekretaren*, *bën kamarierin*; *më mungon* me kuptimin 'kam mall' edhe kjo nga italishtja etj.

Përzierja e kodeve për efekte komike është një tjetër procedë e njohur e ligjërimin studentor. Shprehje, si *bene shyqyr zotit*, *qysh bite*, *shumë gracie*, *shumë thankju*, ku tok me fjalë të shqipes gjen edhe të huaja, kryesisht prej anglishtes e italishtes, janë krejt të zakonshme.

Njësitë e përfutura nëpërmjet atij që prof. Qemal Haxhihasani e quante *alternimi mekanik* e me të cilin kuptonte kombinimet e rrokjeve argotike dhe kthimin e fjalëve mbrapsht, janë fort të rralla në ligjërimin e sotëm studentor. Ndër to po sjell si shembull *thupe* 'puthe', ndërsa te *fake* që prof. Shkurtaç e lidh me 'kafe'²³, unë shoh një derivat të anglishtes *fuck*. Si një lloj shndërrimi mekanik mund të çmohet edhe kthimi i polivibrantes *rr* në monovibranten *r* te fjalë si: *bur* 'burrë', *bir*

²³ Shih Gjovalin Shkurtaç, *Etnografi e të folurit të shqipes*, SHBLU, Tiranë, 2004, f. 215.

‘birrë’, *sher* ‘sherr’, të cilin studentët e përdorin krahas mjeteve të tjera të natyrës prozodike, kur duan të imitojnë të folurit e homoseksualëve për t’i dhënë ngjyresa sa më femërore.

Prej ligjërimeve të tjera rinore të këtyre viteve hynë në atë studentor edhe *respekte* ‘përshëndetje’, *xhek me nric* ‘jack daniel’s me akull’ etj., të cilat studentët i përdorin vetëm kur duan t’i imitojnë të fortët për t’i vënë në lojë. Ndikim të madh në përhapjen e këtyre njësive pati edhe emisioni *Portokalli* i Top Channel-it, njëri prej personazheve të të cilit, *Nini i Bules*, në rolin e *një të forti* nga Shijaku, u kthye në emetuesin kryesor të njësive të tilla. Ky, pos të tjerash, mbahet mend edhe për popullarizimin e *konçentracione*, në përkthimin e *Ninit të Bules* ‘mos u hallakat’ (nga italishtja *concentrazione*). Megjithatë, s’duhet të mendojmë se këto nuk njiheshin edhe më parë, por në gojën e një personazhi televiziv të suksesshëm patën një tjetër jehonë.

Një burim i pashtershëm për pasurimin e fondit leksikor të ligjërimit studentor ka qenë dhe mbetet gjuha e filmit dhe e teatrit. Fjala është për batuta të gatshme, të cilat, falë ndonjë elementi të formës a të përmbajtjes, kanë qenë të afta të lënë mbresa, duke e merituar kësisoj edhe përfshirjen në ligjërimin studentor; shpesh për këtë ka ndihmuar edhe konteksti ose koteksti. Në të shumtën e herës ato janë rikuptimësuar varësisht prej situatave në të cilat përdoren, por nuk mungojnë as rastet kur kanë ruajtur të njëjtin kuptim edhe në entitetin që i ka mirëpritur. Lista e njësive të tilla është mjaft e gjatë, por unë do të mjaftohem me disa shembuj: *me këtë me xham*, *apo me këtë pa xham* – *ata po ashusheshin* (nga filmi *Kapedani*); *e hongrën zybat* (është ndryshuar në *e hongri zyba* nga filmi *Debatiku*); *po me urën ç’patën xhanëm* – *Tahir, lluku babashta* (nga filmi *Kur zbardhi një ditë*); *kte nusen do ta morim partizone* – *s’ka gjo ije, ne do fitojmë* – *edhe hoxh efenia i ka bo lanet partizonët* – *dridhni nga një cigar, është nga duhani i Rremës* (kjo e fundit është ndryshuar në *ndize një nga kutia e Rremës* nga filmi *Shtigje lufte*); *dorëzoja dhjetëshen Gjergjit* (nga filmi *Njësi*

gueril); *gëlltit diku një lugë çorbë të prishur dhe vjell tërë jetën* (nga filmi *Ilegalët*); *gërmo Tare, gërmo – thesin, aga* (nga filmi *Përballimi*); *burrë i pashëm kodoshi, i zgjedhin komisarët – fitore Islam* (nga filmi *Dueli i heshtur*); *me tre aspra dashka verë të mirë miku – është flori e shkuar floririt, or Tunxh* (nga filmi *Udha e shkronjave*); *Abedin, mbaj shënim* (nga filmi *Këshilltarët*); *mishi tretet, kocka mbetet* (nga filmi *Mësonjëtorja*); *bishti i qenit sado që ta drejtosh, prapë i shtrembër mbetet* (nga filmi *Dora e ngrohtë*); *kështu i flitet mësuesit more karafil* (nga filmi *Shoku ynë Tili*); *jeta është llogari, Olimbi* (nga komedia *Karnavalet e Korçës*); *kur bën dashuri edhe Sandër mafishja, i biri i tetos – të ka faj lulka mor, të ka faj* (nga komedia *Pallati 176*) etj. Edhe një fakt nga kronika. Kur Edi Rama e akuzoi ish-kryetarin e tij, Fatos Nanon, se ishte bërë *Robert Çamçakizi* i Partisë Socialiste, Departamentit të Filmit në Televizionin Publik Shqiptar iu drejtuan mjaft kërkesa, pas gjasash nga të rinjtë, për të ritransmetuar filmin *Horizonte të hapura*. Është e vërtetë se disa nga këto njësi mund t'i hasësh edhe në gjuhën e përbashkët, megjithatë hedhja e tyre në qarkullim mbetet ekskluzivitet i ligjërimeve rinore. Afërmendsh që frekuenca e përdorimit të këtyre njësisive kushtëzohet edhe prej faktorëve të jashtëm, si fjala vjen transmetimi ose jo në televizion i filmave të tillë.

Fondi leksikor i ligjërimit studentor pasurohet edhe nga të ashtuquajturat *teknicizma*, pjesa më e madhe e të cilave, siç mund të merret me mend, vjen nga fusha e informatikës, e telefonisë së lëvizshme, e automobilizmit dhe e mjekësisë. Njësi të tilla si: *jepi një enter* 'mbylle me kaq', *tre bajt memorje ka* 'nuk mban mend'²⁴, *me kopi pejst; ma nis me sms, njësh yll thurje* 'i varfër'; *s'ka tokzim* 'nuk kupton', *shtrin kabllin* 'përpiqet të lidhet me ndonjë vajzë', por edhe si

²⁴ Shih Gjovalin Shkurtaç, *Etnografi e të folurit të shqipes*, SHBLU, Tiranë, 2004, f. 219.

aludim për marrëdhëniet seksuale, *ma merr me miza* ‘nuk e kuptoj mirë’, *elektron i lirë* ‘djalë a vajzë pa të dashur’; *çfarë parakolpi* ‘për një vajzë me gjoks të madh’, *i ka balestrat copë*, *i ka amortizatorët e rënë* ‘për një vajzë bishtdredhur’, *hap krahun* ‘tërhiq, mënjanohu’, nuk i punon asnjë kandeletë ‘nuk kupton, është i trashë’; *çfarë stresi* ‘një situatë problematike’, por edhe ‘një njeri i mërzitshëm’, *paska anatomi të bukur* ‘për një vajzë me trup të bukur’²⁵, janë vetëm disa shembuj të një liste të begatë.

Edhe pse duket se politika pak u intereson studentëve të sotëm, në ligjërimit e tyre nuk mungojnë njësitë që e kanë burimin te terminologjia e kësaj fushe. Ndër to po sjell vetëm disa shembuj: *me konsensus*, *me tolerancë*, *vuri veton*, *me orientim nga lart dhe me propozim nga poshtë*, *kriptokomunist*, *është pishtar* ‘për ndonjë idhtar të flaktë të Partisë Demokratike’, pas të gjitha gjasave, për shkak të dekoratës Pishtar i Demokracisë, *është i Freshit* ‘për një anëtar të Forumit Rinor Eurosocialist të Shqipërisë, FRESSH’, që nuk i shpëton dot shoqërim-it të ideve me *Fresh* (një lloj pijeje freskuese), *nga ata të Kopit* ‘për një anëtar të Komitetit të Orientimit të Politikave KOP, në Partinë Demokratike’, *komisioni i virgjërisë* ‘komisioni i pastërtisë së figurës së politikanëve’ etj. Interes paraqet edhe ‘rigjallërimi’ i sloganeve të vjetra politike në ligjërimit studentor: *droga çan bllokadën* (pas gjasash nga *kromi çan bllokadën*), *secili për vete, zoti për të gjithë* (si kundërvënie ndaj sloganit *një për të gjithë e të gjithë për një*), *një bie, mijëra ngrihen* etj. Nga fundi i viteve ’80 studentët e Universitetit të Tiranës e quanin preshin *besniku i Partisë*, meqë ishte i vetmi artikull ushqimor që nuk mungonte në dyqanet e atyre viteve. Me këtë emërtim deri në atë kohë njihej Hysni Kapo, njëra prej figurave kryesore të regjimit, me gjasë, për shkak të pseudonimit *Besniku* që ai kishte mba-

²⁵ Po aty.

jtur gjatë Luftës. Syrit të studentëve nuk mund t'u shpëtonin edhe ato më të rejat, si fjala vjen *do fitojmë apo jo, Nano go* etj. Kohët e fundit ka nisur të përdoret edhe *u bone ti*, duke marrë shkas prej sloganit *u bëre ti* të lëvizjes “Mjaft” në luftën kundër korrupsionit.

Nga gjuha e reklamës tërheqin vëmendjen jam një telefonatë larg, ne s'jemi më të mirët, por më të mirë s'kemi parë, çfarë po thojë, red bull të bën me krahë etj.

Edhe emrat e personazheve të filmave vizatimorë kanë hisen e tyre në ligjërimin studentor. Mjaft syresh studentët i përdorin si nofka për njëri-tjetrin, për mësimdhënësit e për figurat publike. Nga këto të fundit po sjell si shembull *tao-tao*, me të cilin studentët e Universitetit të Tiranës quanin deri në mesin e viteve '90 ish-kryeministrin e Shqipërisë, Adil Çarçanin; *shreku* për presidentin aktual të Republikës, Alfred Moisiun, etj.

Në këtë entitet nuk mungojnë as njësitë e pamotivueshme si nga forma, ashtu dhe nga përmbajtja. Fjalë të tilla si: *fuks*, *kalec* (nga *karkalec?*), *fyr*, të cilat mbartin kuptime të dallueshme qartë, duket se veç tingëllimit të pazakontë nuk kanë ndonjë atribut tjetër. Është e vërtetë se njëra prej tyre, *fuks*, e ka zgjeruar çerdhen e vet me foljen *fukson*, por ky fakt nuk na ndihmon për ta zgjidhur problemin.

Shfaqjet e hiperkorrektesës që vihen re në ligjërimin studentor, për shembull *mirëbërës* për *bamirës*, më shumë se me një përpjekje të vetëdijshme për t'iu afruar modelit me prestigj më të madh, ose grupit shoqëror dominant, duhen lidhur me pasigurinë gjuhësore të të rinjve.